P.nr.1657/13

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Lumnije Krasniqi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bardha Krasniqi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.P., për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë, nga neni 253 par. 1 pika 1 të KPK-së, sipas aktakuzës sëProkurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.7409-3/11, datë 19.04.2013,pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë marrë pjesë prokurorii shtetit Rrahim Podvorica, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit, av.M.N.,më datë 17.12.2018,mori dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari **A.P.,** nga i ati F., dhe e ëma B., e vajzërisë M., data e lindjes..., në P., ku edhe tani jeton, në rrugën "E.H." nr..., ka të kryer shkollën fillore, punon në a., i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:
Me datë 09.11.2009, në mes të orëve 08:00-12:00, në rrugën e "Zagrebit", saktësisht në Bll-23, nr.9-Prishtinë, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja vetit t'i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, pasi ishte siguruar se i dëmtuari F.K. dhe bashkëshortja e tij ishin larguar nga banesa, fillimisht me përdorimin e forcës me mjet të përshtatshëm të pa identifikuar e ka hapur derën e hyrjes, pasi paraprakisht e kishte dëmtuar cilindrin dhe bravën, e më pas ka depërtuar brenda në banesë duke kontrolluar nëpër dhoma të banesës, në veçanti në dhomën e fjetjes dhe nga aty ka marrë ari dhe gjëra tjera të çmueshme, si zingjir ari, unaza ari, rrathë ari, vath në vlerë prej 1080 Euro, e më pas është larguar nga vendi i ngjarjes, duke i shkaktuar kështu dëm të konsiderueshëm material të dëmtuarit të F.K.,

- me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së,

Prandaj, kjo Gjykatë, në bazë të nenit 3, 6, 11, 15, 34, 41, 42, 43, 44, 64 dhe 65 të KPK-së, dhe nenit 359, 361, 365, 366 dhe 450 të KPPRK-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Me të cilin i vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse nuk kryen vepër tjetër penale për kohën e verifikimit në kohëzgjatje prej 2 viteve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës,ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumën prej pesëdhjetë(50) €, të gjitha brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari F.K., me vendbanim në P., rruga e “Z.” Bll-..., kati i dytë, nr. ..., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civilo-juridik.

A r s y e t i m

ProkuroriaThemelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën, PP.nr.7409-3/11, të datës 19.04.2013, ndaj të pandehurit A.P., për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë, nga neni 253 par. 1 pika 1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestarme datë 17.12.2018, në të cilën u dëgjuan prokurori ishtetit Rrahim Podvorica, i akuzuari A.P. dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit, av.M.N., ku pasi që prokurori i shtetit e lexoi aktakuzën, menjëherë të akuzuarit ju dha mundësia për ta pranuar fajsësinë apo të deklarohet i pa fajshëm për veprën penale e cila i vihet në barrë.

I i akuzuari në shqyrtimin fillestar, deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën në tërësi, me vullnet të plotë dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë dhe pranon fajsinë për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës, duke shtuar se kërkon falje dhe është penduar për veprimet e tij, se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i moshës së re, ndërsa tani është i martuar dhe ka tre fëmijë, dhe e ka gjendjen e vështirë shëndetësore dhe ekonomike, dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprën penale.

Pas pranimit të fajësisë nga i i akuzuari, gjykata ka marrë mendimin e mbrojtësit të tij sipas autorizimit, av.M.N., i cili ka deklaruar se e mbështetë deklaratën e të mbrojturit të tij lidhur me pranimin e fajësisë për veprën penale, pasi që i njejti është konsultuar mjaftueshëm lidhur me pasojat e pranimit dhe se ky pranim bëhet në mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, andaj i ka propozuar gjykatës që ta aprovojë këtë pranim të fajësisë dhe me rastin e shqiptimit të dënimit ta marrë për bazë si rrethanë lehtësuese së bashku me rrethanat tjera si: pendimin e të pandehurit për kryerjen e veprës penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, faktin se është i martuar dhe baba i ... fëmijëve, dhe sidomos faktin se nga koha e kryerjes së kësaj vepre penale kanë kaluar më shumë se 9 vite.

Prokuroriishtetit Rrahim Podvorica, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, meqenëse pranimi i fajësisë është bërë konform nenit 248 të KPK-së dhe është në përputhje të plotë me provat që i janë bashkangjitëaktakuzës.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandeuri dhe deklarimeve të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të akuzuarit, gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke shprehur bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe paosjat e pranimit të fajësisë dhe se ky pranim mbeshtetet edhe në provat të cilat gjenden në shkresa të lëndës siq janë: Raporti i ekspertizës trasologjike-daktiloskopike nr.2011-2326/ 2011-2433, të dt.10.11.2011, si dhe foto-dokumentacioni që gjendet në shkreat e lëndës, nga të cilat prova gjykata gjen se në veprimet e të pandehurit A.P., formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së.

Andaj, gjykata të njëjtinta shpalli fajtor, pasi qe gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në bazë të nenit 64 dhe 65të KPK-së, në rastin konkret gjykata mori parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për këtë vepër penale dhe gjeti se: i pandehuri e ka pranuar fajësinë që në seancën e shqyrtimit fillestar, është penduar lidhur me kryerjen e veprës penale,ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, faktin se tani është i martuar dhe baba i ... fëmijëve dhe mbajtës i vetëm i familjes,se e ka gjendjen e dobët ekonomike, e veçanërisht faktin se tani e ka gjendjen e rëndë shëndetësore dhe se nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar një kohë relativisht e gjatë, rreth 9 vite, ndërsa rrethana rënduese gjykata gjeti se i njëjti ka qenë edhe më parë i dënuar. Andaj, gjykata konform nenit 42 dhe 43 të KPK-së, i shqiptoi dënim me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse nuk kryen vepër tjetër penale për kohën e verifikimit në kohëzgjatje prej 2 viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësisë penale, dhe se i njëjti do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 34 të KPK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 të KPPK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore-juridike është marrë në bazë të nenit 463 par.2 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1657/13, dt.17.12.2018

Procesmbajtësja,
Bardha Krasniqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Lumnije Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE:
Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.